



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria e Arsimit

Nr. 572 /23

Datë: 09-07-2023

Ne baze dispozitave të nenit 24.2 dhe 24.5 të Ligjit Nr. 02/L-52 Mbi edukimin parashkollor, nenin 3 të UA Nr. 41/2007, dt. 9.10. 2007 Zbritja e tarifave që duhet të paguhet nga prindërit për me shumë se një fëmijë në institucionet parashkollore, UA Nr.03/2022 Për përfshirjen e fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë. Drejtoria për Arsim publikon këtë:

NJOFTIM

1. Për lirim nga pagesa për fëmijët në Institucione Parashkollore për vitin shkollor 2023/2024.

Te drejte lirimi nga pagesa kanë vetëm:

- a) Fëmijët e invalidëve të luftës lirohen nga pagesa 100%
- b) Fëmijët bonjak (pa të dy prindërit) 100%;
- c) Fëmijët me nevoja të veçanta 100%
- d) Fëmijët në asistencë sociale 100%
- g) Fëmijët me njërin prind lirohen 100%;
- d) Fëmijët e veteraneve të luftës 100%;
- e) Prindërit që kanë me shumë se një fëmijë në IP të regjistruar, për një fëmijë do të paguaj tarifën e plotë, për fëmijën e dytë lirohet 30%, për fëmijën e tretë lirohet 50% nga tarifa aktuale (kjo kategori mund të aplikoj vetëm në një Institucion Parashkollor).

II. Te gjithë parashtruesit e kërkesave duhet të paraqesin këto dokumente:

- Kërkesën për lirim nga pagesa për vitin 2023/2024.
- Certifikatën e lindjes së fëmijëve
- Kopjen kontratës me IP

Invalidët e luftës duhet të paraqesin edhe:

- Vendimin origjinal (ose kopjen e vërtetuar të noteri) të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të pensionit për invalid të luftës;

Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta edhe:

- Vërtetimin zyrtar për fëmijën me nevoja të veçanta (vërtetimi nga HANDIKOS apo nga Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale).

Prindërit e fëmijëve ne asistence sociale edhe:

- Vërtetimin zyrtar që dëshmon periudhën aktuale që janë ne asistence sociale nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kujdestaret e fëmijëve bonjak (pa të dy prindërit) edhe:

- Certifikatën e vdekjes së prindërve (origjinale)

Prindi i vetëm pa bashkëshorte/bashkëshort edhe:

- Certifikatën e vdekjes së bashkëshortit/es (origjinale)

Prindi vete-ushqyes edhe:

- Dokumentin zyrtar se jeni prind vete-ushqyes.

Prindërit që kanë me shumë se një fëmijë të regjistruar në çerdhet publike edhe:

- Certifikatën e lindjes të secilit fëmijë (origjinale) dhe fletëregjistrimin e tyre në institucionet përkatëse.

VEMENDJE: Për të gjitha rastet e liruara nga pagesa prindërit kujdestaret ligjor, duhet të dëshmojnë me dokument zyrtar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kërkesën e lirimit, në të kundërtën e njëjta do të refuzohet.

III. Lirimi nga pagesa, bëhet nga 1 shtatori i vitit 2023 deri 31 Gusht 2024. **Kërkesat dorëzohen në administratën e IP-se përkatëse.**

Afati për paraqitjen e kërkesës është nga dt. 20.07.2023 deri me dt. 28.07.2023 Në publikimin e listës në tabelën e shpalljes në IP, **udhëzohet pala e pakënaqur** se ka të drejtë të paraqet ankese për rishqyrtimin e vendimit të komisionit, **ne IP- ne përkatëse, në afat prej tri (3) ditëve**, jo në Drejtorinë e Arsimit.

Palët e pakënaqura me përgjigjen e IP-se, mund të bëjnë ankese në DKA, si shkallë e dytë në afat prej tetë (8) ditëve. DKA nuk shqyrton asnjë ankese nëse e njëjta fillimisht nuk është paraqitur në IP-ne përkatëse.

Vërejtje: Te gjitha dokumentacionet e pakompletuara, dhe jashtë afatit zyrtar të parapare në këtë njoftim nuk do të shqyrtohen.



Dardan Abazi
Drejtör i DKA-së.